



**REPUBLIKA E KOSOVES**  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
OSNOVNI SUD PRISTINA - BASIC COURT OF PRISTINA

---

**AD/GJTHPR/25/24**

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Albina Shabani Rama, ka shqyrtuar ankesën e ushtruar nga av. L.S ndaj gjyqtarit A.M, për të vendosur për çështje disiplinore, duke vepruar në mbështetje të nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7, paragrafi 1 dhe 3 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 25.11.2024 nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e ushtruar nga av. L.S ndaj gjyqtarit A.M për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

**A r s y e t i m**

Av. L.S me datë 11.11.2024 së bashku me kërkesën për përjashtim, ka paraqitur kërkesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit A.M, me pretendimet për shkelje disiplinore të parapara me nenin 5 të Ligjit për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Parashtruesi i ankesës në ankesën e tij ka deklaruar se gjyqtari A.M ka kryer shkelje disiplinore të parapara me nenin 5 par 2, pika 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.8 të Ligjit 06/L-057, me arsyetimin se nga fillimi i angazhimit në këtë rast kanë vërejtur se gjyqtari nuk ka pasur interes ta trajtoj rastin me seriozitetin e merituar si dhe duke favorizuar qartazi palën tjetër, por që sipas tyre janë munduar që ta kuptojnë faktin se pala kundërshtare është femër dhe si rrjedhojë mund të mendojë se i nevojitet mbështetje emocionale, mirëpo sipas tyre gjyqtari ka arritur në një gjendje që nuk i ka interesuar fare pretendimi i palës të cilën avokati në fjalë e përfaqëson, duke favorizuar palën tjetër deri në shkelje të ligjit dhe duke krijuar një situatë të cilën sipas parashtruesit të kësaj ankese nuk kanë mundur ta përballojnë proceduralisht dhe profesionalisht. Tutje ka deklaruar se në asnjë mënyrë nuk po i mundësohej që të parashtrohen prova dhe fakte relevante për çështjen, refuzoheshin të gjitha propozimet pa trajtim fare por vetëm aty për aty, nuk merrej fare në konsideratë pozita e cenueshme e palës tjetër që nuk e ka parë vajzën e tij tash më shumë se një vit, ku gjyqtari ka lejuar një QPS tërësisht të njëanshme dhe qëllimisht joprofesionale që të menaxhoj lëndën përkundër provave evidente për përjashtim të saj, e ku gjatë procedurës pala kundërshtare ka qasje të njëanshme në anamnezën e QPS kur ne nuk kemi pasur, por gjyqtari kërkon nxjerrje të provave që i përgjigjen vetëm interesave të palës tjetër pa kërkuar fare pala tjetër, e nuk interesohet fare për kontaktin e munduar që një vit të palës që i njëjti përfaqëson. Tutje ankuesi ka deklaruar se në kërkesën për përjashtim të gjyqtarit e cila është paraqitur në seancë me njoftimin se argumentimi i kësaj

kërkese do të bëhet me deklaram shtesë me shkrim, ku në bazë të këtij propozimi është ndërprerë seanca, mirëpo sipas ankuesit kërkesa është procedura pa u kërkuar fare plotësim të parashtrës me deklarimet shtesë për arsyet e përjashtimit, përkundër që ishim në përgatitje të saj, duke vënë kështu në lajthitje procedurale Kryetaren e Gjykatës, e cila ka vendosur në lidhje me një kërkesë të mangët e të paplotësuar. Sipas tij, kjo vë në pah ndjenjën e fajësisë së gjyqtarit gjegjës dhe tendencën që çështjen e kërkesës ta kalojë pa u trajtuar në bazë të provave dhe fakteve relevante për përjashtimin e tij.

Tutje në deklaramin e tij ankuesi ka potencuar se në seancën e datë 29.05.2024, përkundër që pala e paditur shprehi shqetësimin për pamundësimin për kontakt me fëmijën e tij në QPS në Skenderaj, e po ashtu në lidhje me kërkesën e tij që kjo QPS të përjashtohet, gjyqtari ka zgjedhur të mos merret fare me atë kërkesë, e kjo sipas tij kuptohet gjatë seancës ku ai nuk i kupton fare pretendimet e paraqitura, e ku pastaj vendosi që ta refuzojë kërkesën për përjashtim pa asnjë arsyetim.

Ndër të tjera ka deklaruar se gjyqtari ka një qasje që të refuzoj të gjitha kërkesat e një pale vetëm pse është burrë dhe të angazhohet që të sigurojë të gjitha kërkesat e një pale vetëm pse është grua, por gjyqtari në fjalë me këtë qasje ka lënë fëmijën pa alimentacion vetëm pse propozimi ka qenë i palës që i njëjti përfaqëson si dhe ka lënë me një anë një çështje kryesiale për zhvillimin normal të fëmijës, siç është kontakti, vetëm pse ai u ngrit nga një burrë.

Në fund ka deklaruar se gjyqtari ka shkelur rëndë parimin e barazisë së palëve në procedurë dhe parimin e paanshmërisë, duke humbur denjësinë për të qenë gjyqtar në këtë lëndë.

Në lidhje me ankesën e parashtruar, gjyqtari i çështjes ka deklaruar se pretendimet e të njëjtit kryesisht konsistojnë në tre elemente: refuzimin e propozimeve të tij në seanca gjyqësore pa arsye të mjaftueshme që lidhen me Qendrën për Punë Sociale në Skenderaj, diskriminimin e palës të cilin e përfaqëson dhe nxjerrjen e provave në mënyrë të njëanshme pa propozimin e palëve.

Në raport me pretendimin për refuzimin e pretendimeve të autorizuarit të paditurit, përkatësisht refuzimin e kërkesës për përjashtimin e Qendrës për Punë Sociale në Skenderaj, gjykata ka vendosur përmes aktvendimit në procesverbal në seancën e datës 29.05.2024, ndërsa me aktvendimin e veçantë jashtë seancës, sipas kërkesës së të autorizuarit të palës së paditur, gjykata e ka arsyetuar marrjen e këtij aktvendimi. Sipas gjyqtarit, lidhur me këtë, është vlerësim i gjykatës, se lidhur me veprimet përkatësisht detyrat zyrtare të zyrtarëve të QPS-së në Skenderaj, të njëjtit i nënshtrohen një mbikëqyrje tjetër, për të cilën gjykata nuk mund të ketë ndonjë ndikim përmes kësaj procedure. Për më shumë, sipas gjyqtarit, ky pretendim mund të atakohen së bashku me vendimin përfundimtar, dhe i njëjti mund të jetë subjekt i vlerësimit nga gjykata e nivelit më të lartë, e po ashtu është në vlerësimin e gjykatës se cilat propozime duhet të aprovohen e cilat të refuzohen, ashtu siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Në vijim, gjyqtari ka deklaruar se pasi që pala paditëse jeton në Komunën e Skenderajt, gjykata nga Qendra për Punë Sociale në Skenderaj ka kërkuar anamnezën sociale me qëllim të analizimit të rrethanave lidhur me besimin e fëmijës së përbashkët të palëve ndërgjyqëse, ku nga kjo qendër gjykata ka pranuar anamnezën sociale, përmes të cilës janë dhënë edhe rekomandimet. Më tutje, gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor në të cilën ka marrë

pjesë përfaqësuesja e kësaj Qendre dhe njëkohësisht i është përgjigjur pretendimeve të autorizuarit të palës së paditur.

Në seancën e shqyrtimit kryesor, palët ndërgjyqësore e kishin mundësinë që të shprehin të gjitha pretendimet në raport me rekomandimet e QPS-së dhe në fund gjykata do të vlerësojë nëse këto rekomandime janë të qëndrueshme dhe fillimisht i përgjigjen interesit më të mirë të fëmijës, pa përjashtuar edhe të drejtat e palëve ndërgjyqëse.

Ndërsa, në raport me pretendimet se pala të cilën e përfaqëson i autorizuari i tij, është diskriminuar në këtë procedurë dhe se gjykata ka nxjerrë prova në mënyrë të njëanshme, gjyqtari ka deklaruar se Ligji për Familjen i Kosovës, në kontestet për besimin e fëmijëve dhe pagesën e alimentacionit parasheh që gjykata duhet të ketë rol aktiv dhe të hetojë të gjitha rrethanat e çështjes lidhur me këtë, me nenin 144 par. 1 të këtij Ligji, parashihet se “ Gjykata ose Organi i Kujdestarisë, i cili e merr vendimin mbi besimin e fëmijës për ruajtje dhe edukim, ka për detyrë që në mënyrë të përshtatshme ti hetojë të gjitha rrethanat që janë me rëndësi për zhvillimin e drejtë psikik dhe fizik për edukimin e fëmijës. Ndërsa, më tutje gjyqtari ka deklaruar se me të njëjtin Ligj, në nenin 325 par.1 përcaktohet se “ Në çdo rast që të jetë e mundshme, vendimet për mbrojtjen dhe mbajtjen e fëmijëve në kontestet martesore do të jenë ex-officio ( në bazë të detyrës zyrtare). Andaj, bazuar në këtë dispozitë, gjykata i është drejtuar Trustit Pensional të Kosovës dhe Administratës Tatimore të Kosovës për të dy palët ndërgjyqëse për të konstatuar, nëse të njëjtit janë të punësuar dhe cilat janë të hyrat e tyre, procedurë kjo standarde dhe që zhvillohet për çdo rast, pavarësisht deklarimit a po propozimit të palëve.

Në referim të pretendimeve të parashtruesit të ankesës si dhe bazuar në Ligjin për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, për Autoritetin Kompetent ishte e rëndësishme gjetja e shkeljeve të cilat janë pretenduar nga parashtruesi i ankesës të cilat parashihen me nenin 5 të Ligjit Nr. 06/L – 057, *paragrafi 2 pika 2.1 e cila parasheh kryerjen e detyrave zyrtare duke mos respektuar parimin e pavarësisë dhe paanshmërisë gjyqësore duke vepruar me paragjykime në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike dhe sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal të palës në procedurë, pikës 2.2 e cila parasheh mos trajtimin siç kërkohet me ligj të palëve në procedurë, përfaqësuesit e tyre, dëshmitarët, dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë, pikës 2.3 që parasheh komunikimin e informatave jo-publike të marra gjatë kryerjes së detyrës zyrtare personave të paautorizuar, si dhe pika 2.8 që parasheh përfshirjen në çfarëdo komunikimi ex-parte, lidhur me lëndët.*

Në lidhje me pretendimin për shkelje disiplinore të parapara me nenin 2.1, Kryetarja e Gjykatës nuk ka arritur të provojë pretendimet e palës ankuese, pasi që në këtë drejtim parashtruesi i ankesës nuk ka ofruar prova për të argumentuar se si rezultat i cilave fakte ka arritur të konstatoj se gjyqtari ka shkelur pavarësinë e tij, a po është treguar i njëanshëm, a po çfarë sjellje është manifestuar nga gjyqtari i rastit e cila bie ndesh me Kodin e Etikës për gjyqtarë apo veprime të cilat hyjnë në domenin disiplinor.

Vërtetimet a po vlerësimet e gjykatës së shkallës së parë a po veprimet e ndërmarra me qëllim të nxjerrjes së vendimit, nuk mund të jenë arsye për inicim të procedurës disiplinore për gjyqtarin, a po të pretendohet se gjyqtari i çështjes është treguar i paanshëm a po ka shkelur

parimin e pavarësisë, kjo sepse për mënyrën e vendosjes së çështjes, gjyqtarët veprojnë konform ligjit, në bazë të bindjes së lirë, pa asnjë presion apo ndikim nga kushdo qoftë, bazuar në provat/shkresat e lëndës, të thënat e palëve në procedurë si dhe legjislacionit në fuqi.

Po ashtu, të paprovuara kanë mbetur edhe pretendimet e tjera për shkelje disiplinore të parapara me pikat 2.2, 2.3 dhe 2.8, pasi që në bazë të shkresave të lëndës, respektivisht procesverbaleve gjyqësore të cilat janë të vetmet shkresa ku palët mund të konstatojnë shkeljet e ndodhura gjatë seancave gjyqësore, nuk është konstatuar asnjë ankesë për mos trajtim të duhur të palëve, a po trajtim i palëve në kundërshtim me ligjin në fuqi. Ndërsa, mbetet e paqartë se çfarë informatash jo-publike i ka komunikuar gjyqtari personave të paautorizuar, a po kush janë personat e paautorizuar në këtë lëndë gjyqësore dhe cilat janë informatat që janë komunikuar.

Po ashtu, parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë fakt të vetëm në lidhje me pretendimin për komunikim ex parte të gjyqtarit, për çka pretendimi i tillë ka mbetur i paprovuar. Kjo sepse, parashtruesi i ankesës fillimisht duhet ta ketë të qartë se komunikimi exparte konsiderohet në rastet kur gjyqtari komunikon me një palë pa praninë e palëve të tjera a po përfaqësuesve të tyre, ndërsa çdo komunikim zyrtar i gjyqtarit me institucionet përkatëse si QPS a po Administrata Tatimore në rastin konkret të cilat nuk janë palë në procedurë, nuk mund të konsiderohet si komunikim exparte.

Pretendimet për shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, nuk mund të jenë arsye për inicim të procedurës disiplinore për gjyqtarin e çështjes, kjo pasi që Autoriteti Kompetent – Kryetarja e Gjykatës nuk ka kompetencë të vlerësoj a po të komentoj vendimet gjyqësore, kjo kompetencë i takon vetëm gjykatës së shkallës së dytë, që të vlerësoj nëse si rezultat i shkeljeve procedurale a po materiale të bëra nga gjykata e shkallës së parë është bërë konstatim i gabuar i gjendjes faktike a po është shkelur ligji në dëm të palës tjetër.

Andaj, Autoriteti Kompetent ka vlerësuar se aplikimi i gabuar dhe jo i drejtë i te drejtës materiale apo procedurale nga ana e gjyqtareve gjatë punës se tyre, mund të jete shkak për ushtrimin e ankesës nga ana e palës se pakënaqur ne Gjykatën e instancës me te lartë, e qe kjo çështje lidhet me aspektin profesional te gjyqtarit dhe e njëjta mund te shërbej si kriter ne vlerësimin e performancës se gjyqtarit te caktuar, por jo te konsiderohet shkelje disiplinore nga ana e të njëjtit.

Në këtë drejtim, me nenin 107 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës parashihet: “Gjyqtarët, gëzojnë imunitetin nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga funksioni, për vendimet e marra, votimin e bërë, mendimin e shprehur dhe për veprimet e tjera të ndërmarra që janë brenda fushëveprimit të detyrave dhe përgjegjësive të tyre si gjyqtarë”, e po ashtu parimi i njëjtë mbrohet edhe nga instrumentet ndërkombëtare ku në Deklaratën Universale mbi Pavarësinë e Gjyqtareve, ku parashihet: "Gjykatësit gjatë ushtrimit të detyrave të tyre duhet të jenë të lirë për të vendosur mbi çështjet në mënyrë të paanshme, në përputhje me vlerësimin e tyre të lirë të fakteve dhe të kuptuarit e tyre të ligjit”.

Nga të lartcekurat, Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me ankesën e ushtruar, bazuar në të dhënat e përshkruara më lartë, vlerësoj se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore, për t'i parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë, në bazë të nenit 7, paragrafi 3, të rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**

AD/GJTHPR/25/24, me datë 25.11.2024

Albina Shabani Rama

---

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë